



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 17 tetor 2017

Numri i lëndës: 2016-06 & 2017-04

Shpresim Uka

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 17 tetor 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Elka ERMENKOVA, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa nr. 2016-06 ishte regjistruar në Panel me datën 27 prill 2016. Ajo ishte paraqitur nga z. Shpresim Uka përmes përfaqësuesit të vet të autorizuar, znj. Mirvete Uka.
2. Ankesa nr. 2017-04 ishte regjistruar me datën 22 qershor 2017. Ajo ishte paraqitur personalisht nga z. Shpresim Uka.
3. Duke marrë parasysh shkallën në të cilën çështjet e ngritura nga këto dy ankesa përfshinë të njëjtën gjë, Paneli me anë të kësaj i bashkon

zyrtarisht këto dy lëndë në përputhje me rregullën 20 të rregullores së punës.

II. FAKTET

4. Me 17 dhjetor 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka gjetur ankuesin fajtor për vrasje të rëndë në bashkëkryerje dhe për tentim vrasje të rëndë në bashkëkryerje. Ankuesi është dënuar me 15 vjet burgim. Rasti njihet si "Bllaca 2". Një gjykatës i EULEX-it kishte marrë pjesë në gjykim.
5. Me 12 dhjetor 2013, Gjykata e Apelit ka ndryshuar pjesërisht aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë. Kjo Gjykatë ka vërtetuar dënimin e ankuesit.
6. Me 3 shtator 2014, Gjykata Supreme ka vërtetuar dënimin e ankuesit.
7. Me 2 shkurt 2015, ankuesi ka paraqitur një kërkesë për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme në Gjykatën Kushtetuese.
8. Me 4 korrik 2016, Gjykata Kushtetuese ka shpallur kërkesën e ankuesit të papranueshme.
9. Me 30 mars 2016, ankuesi ka paraqitur një kërkesë për hetim fillestar ndaj një dëshmitari bashkëpunues në Prokurorinë Speciale të Kosovës. Nuk kishte filluar asnjë hetim.
10. Me 30 mars 2016, parashtruesi i ankesës ka paraqitur një kërkesë për rishqyrtimin e procedurave të Gjykatës Themelore të Prishtinës, Departamenti për Krime të Rënda.
11. Me 6 korrik 2016, Gjykata Themelore e Prishtinës, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka lëshuar një vendim, ku ka refuzuar kërkesën e ankuesit për rishqyrtimin e procedurave.

III. ANKESAT

12. Ankuesi pohon se gjatë gjykimit të tij kishte shumë parregullsi. Së pari, kryetarit të trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut pretendohet se i kishte munguar paanshmëria pasi që ai thuhet se ka bazuar një gjykim të mëparshëm, në gjykimin e njohur "Bllaca 1" në dëshminë e të njëjtit dëshmitar bashkëpunues, në të cilin ai mbështetej për të dënuar ankuesin në procedurat në rastin në fjalë.
13. Së dyti, supozohet se faktet e lëndës nuk ishin vërtetuar në mënyrë të reale dhe në mënyrë të plotë. Në veçanti, ankuesi kritikon vlerësimin e dëshmive të bëra nga gjykata, veçanërisht lidhur me besueshmërinë e dëshmitarit bashkëpunues.

14. Së treti, ankuesi pohon se nuk ishte "trajtuar në mënyrë të barabartë" dhe se nuk kishte asnjë arsye për të kryer krimin në fjalë.
15. Duke iu referuar kësaj çfarë u përmend më sipër, ankuesi pohon se janë shkelur të drejtat e tij sipas nenit 6(1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore.
16. Ankuesi kërkon nga Paneli që të shqyrtojë aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, të nis procedurën ndaj dëshmitarit bashkëpunues dhe kërkon që çështja të kthehet në rigjykim.

IV. LIGJI

17. Ankuesi pretendon në shkelje të nenit 6(1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore (e drejta për gjykim të drejtë). Në këtë dispozitë, për atë që është përkatëse thuhet si në vijim:

Neni 6 E drejta për gjykim të drejtë

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, [...]
 2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale supozohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.
 3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:
[...]
(c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;
(d) të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;
[...]
18. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të zbatojë instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
 19. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendosë nëse do të vazhdojë me ankesat, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së punës.

20. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në gjyqësi, polici dhe dogana. Në bazë të instrumentit të tij themelues, të përmendur më lartë, rregulli 25 më tej përcakton që Paneli nuk është kompetent për të shqyrtuar procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës.
21. Sa i përket kërkesave (shih më sipër paragrafin 16) që Paneli duhet të shqyrtojë procedurat penale dhe çështja të kthehet në rigjykim, ose aktgjykimi të shqyrtohet, Paneli vëren se ankuesi kundërshton vendimet e lëshuara nga gjykatat e Kosovës dhe pajtueshmërinë e këtyre vendimeve me standardet përkatëse të të drejtave të njeriut, në veçanti me garancitë procedurale të parashikuara në nenin 6 të Konventës.
22. Paneli rithekson se, siç ka konstatuar në shumë raste se sipas rregullës 25, paragrafi 1, bazuar në konceptin e llogaridhënies të OPLAN-it të EULEX-it Kosovë, në parim nuk mund të shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës. Paneli nuk ka kompetencë as në fushën administrative e as në fushën juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Fakti që gjykatësit e EULEX-it janë pjesë e trupin gjykues në ndonjë gjykatë të caktuar, nuk ia humb asaj gjykate karakterin e të qenurit pjesë e sistemit juridik të Kosovës (*ndër të tjera*, shih *Rifat Kadribašić kundër EULEX-it*, 2014-09, e datës 10 nëntor 2014, par. 11, *Shaban Kadriu kundër EULEX-it*, 2013-27, 27 maj 2014, par. 17). Prandaj Paneli nuk ka kompetencë të merret me këtë ankesë.
23. Për më tepër, Paneli thekson që ankuesi nuk ka arritur të shpjegojë se si ndihma që ai kërkon (shih paragrafin 15 më lartë) do të binte në kuadër të kompetencës së Panelit siç është saktësuar në rregullën 25 të rregullores së punës dhe OPLAN-it të EULEX Kosovë.
24. Rrjedhimisht, çështjet e ngritura nga ankuesi nuk bien në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë. Rrjedhimisht, ato janë jashtë kompetencës së Panelit, siç është saktësuar në rregullën 25 të rregullores së punës dhe OPLAN-it.
25. Për më tepër, Paneli thekson që vepra rreth së cilës është bërë ankesa duket se bie jashtë afatit kohor 6-mujor, brenda të cilit duhet të paraqitet ankesa pranë Panelit (Rregulli 25(3) i rregullores së punës së Panelit). Procedurat penale në këtë rast kanë përfunduar me 3 shtator 2014 kur Gjykata Supreme kishte lëshuar aktgjykimin. Ankesat e tanishme janë parashtruar në Panel me 27 prill 2016 dhe 22 qershor 2017. Rrjedhimisht, ato bien jashtë afatit gjashtëmujor të përcaktuar në rregullore. Ankuesi nuk ka paraqitur asnjë arsye bindëse pse megjithatë Paneli duhet të ketë kompetencë për ta trajtuar ankesën e tij. Po ashtu edhe për këtë arsye ankesa duhet të shpallet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për të shqyrtuar ankesën, pasi që ajo bie jashtë juridiksionit të saj në kuptim të nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës dhe nuk është në përputhje me nenin 25(3) të rregullores lidhur me afatin për paraqitjen e një ankese, dhe prandaj

SHPLL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese